



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 20 shtator 2011

Nr. ref.: AGJ138/11

AKTGJYKIM

në

Rastin Nr. KO98/11

Parashtrues

Qeveria e Republikës së Kosovës

**Lidhur me imunitetin e
deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe
anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Kërkesa

1. Kërkesën e parashtroi Kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Qeveria).

2. Më 20 korrik 2011, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Kushtetuese) pranoi kërkesën nga Qeveria, e cila përmbante tri çështje të veçanta. Pyetjet që iu parashtruan Gjykatës kishin të bënin me imunitetin e organeve të ndryshme shtetërore të Kosovës, kryesisht të deputetëve të Kuvendit, Presidentit dhe anëtarëve të Qeverisë.
3. Qeveria konsideroi se ekzistonte nevoja për interpretimin dhe sqarimin e çështjes së imunitetit të deputetëve të Kuvendit, Presidentit dhe anëtarëve të Qeverisë sepse “kjo çështje ka ndikim të drejtpërdrejtë në funksionimin demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës”.
4. Qeveria theksoi se kërkesën e bazoi në nenin 93 (10) dhe nenin 113 (3) (1) të Kushtetutës.

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatë më 20 korrik 2011.
6. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese, dhe e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Enver Hasani dhe Iliriana Islami.
7. Më 22 korrik 2011, Kryetari i Gjykatës e njoftoi Kryetarin e Kuvendit, Presidentin e Republikës së Kosovës dhe Kryeministrin për parashtrimin e kërkesës dhe u kërkoj që brenda 45 ditëve të ofrojnë përgjigje dhe komente në çështjet e ngritura.
8. Përveç kësaj, në letrën drejtuar Kryetarit të Kuvendit, si dhe në letrën plotësuese të 26 korrikut 2011, në të cilën u theksua se do të ishte e dobishme të pranoheshin përgjigjet dhe vërejtjet e deputetëve lidhur me çështjet e ngritura në kërkesë, Kryetari i Gjykatës kërkoj nga Kryetari i Kuvendit që t'i dërgonte shkresat dhe dosjet, dhe posaçërisht:
 - Punët përgatitore të Kushtetutës deri në masën që kanë të bëjnë me disa imunitete sipas neneve 75, 89 dhe 98 të Kushtetutës;
 - Një kopje të plotë të dosjeve të Kuvendit në lidhje me nenet që kanë të bëjnë me imunitetin e deputetëve sipas Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, Ligji Nr. 03/L-111, dhe, në veçanti, kopjet e të gjitha punëve përgatitore të Kuvendit, procesverbalet e të gjitha takimeve dhe tërë korrespondencën lidhur me nenet e sipërpërmendura;
 - Një kopje të plotë të dosjeve të Kuvendit në lidhje me nenet që kanë të bëjnë me imunitetin e deputetëve sipas Rregullores së punës së Kuvendit të Kosovës, të miratuar më 29 prill 2010, dhe, në veçanti, kopjet e të gjitha punëve përgatitore të Kuvendit, procesverbalet e të gjitha takimeve dhe tërë korrespondencën lidhur me nenet e sipërpërmendura;
 - Një kopje të plotë të dosjeve të Kuvendit në lidhje me nenet që kanë të bëjnë me imunitetin e Presidentit të Republikës së Kosovës sipas Ligjit Nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës dhe, në veçanti, kopjet e të gjitha punëve përgatitore të Kuvendit, procesverbalet e të gjitha takimeve dhe tërë korrespondencën lidhur me nenet e sipërpërmendura.
9. Më 21 gusht 2011, z. Nait Hasani, deputet i Kuvendit, ia dërgoi një përgjigje Gjykatës, duke dhënë mendimin e tij lidhur me këto çështje.

10. Më 23 gusht 2011, dr. Jakup Krasniqi, duke iu përgjigjur letrës së Kryetarit të Gjykatës, të 26 korrikut 2011, i shkroi Gjykatës dhe bashkëngjiti një letër të cilën Kuvendi ia kishte dërguar z. Xavier De Marnhac, shef i Misionit të EULEX-it në Kosovë, për këtë çështje, si dhe dërgoi Opinionin ligjor të përgatitur nga Zyra Ligjore e Kuvendit të Kosovës.
11. Kryetarit të Kuvendit iu dërgua një letër tjetër më 8 shtator 2011, me të cilën rikujtohej t'i dërgonte dosjet, shkresat dhe dokumentet e tjera të kërkuara më 22 korrik 2011. Kryetari i Kuvendit iu përgjigj kësaj letre më 9 shtator 2011, të cilën Gjykata e pranoi më 12 shtator 2011. Përgjigjes i ishin bashkëngjitur dosjet e Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit dhe të Rregullores së punës të Kuvendit të Kosovës, të miratuar më 29 prill 2010.
12. Më 9 shtator 2011, Gjykata mori një përgjigje dhe komentet nga z. Visar Ymeri në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje.
13. Më 12 shtator 2011, Gjykata Kushtetuese mori një përgjigje nga znj. Alma Lama, deputete e Kuvendit.
14. Më 13 shtator 2011, Gjykata mori një përgjigje, të 12 shtatorit 2011, nga z. Fatmir Limaj, deputet i Kuvendit.
15. Më 13 shtator 2011, Gjykata mori një përgjigje tjetër, të 13 shtatorit 2011, nga dr. Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit.
16. Përgjigje nuk u pranuan as nga deputetët e tjerë të Kuvendit, as nga Presidentja e Republikës së Kosovës, dhe as nga Qeveria.
17. Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e përgatitur nga Gjyqtarja raportuese Snezhana Botusharova dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë.
18. Më 20 shtator 2011, Gjykata në përbërje të plotë vendosi t'i jepte përparësi kësaj kërkesë për shkak të natyrës së çështjeve kushtetuese të ngritura nga Qeveria dhe me këtë rast u këshillua dhe votoi lidhur me kërkesën.

Përgjigjet edhe komentet

A Përgjigja e z. Nait Hasani, deputet i Kuvendit

19. Z. Nait Hasani theksoi se kishte imunitet të cilin ia garantonte Rregullorja e punës së Kuvendit të Kosovës dhe Kushtetuta. Ai theksoi se imuniteti ishte i përcaktuar qartë dhe se imuniteti i deputetit mund të hiqet nga Kuvendi me kërkesën e organit kompetent për ndjekje penale.

B Përgjigja dhe komentet e Kuvendit

20. Përgjigja e Kuvendit, e 13 shtatorit 2011, drejtuar Gjykatës Kushtetuese, dërguar nga dr. Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, përmbante letrën e tij, të 15 korrikut 2011, dërguar z. Xavier De Marnhac, shef i Misionit të EULEX-it në Kosovë. Në të thuhej se nuk kishte mospërputhje ndërmjet Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit dhe Kushtetutës, dhe se nuk kishte nevojë t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese për këtë çështje. Ai theksoi se referimi i një çështjeje në Gjykatën Kushtetuese ishte tërësisht në diskrecion të Qeverisë dhe nuk nevojitej rezoluta e Kuvendit për këtë. Në letër thuhej që Kuvendi do të mund të ndërmerre veprime procedurale lidhur me imunitetin vetëm në rastin kur kjo kërkohet nga Prokurori i Përgjithshëm, duke u bazuar në nenin 9 (3) të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit.

21. Opinioni Ligjor i Zyrës Ligjore të Kuvendit të Kosovës identifikonte dispozita të caktuara kushtetuese dhe ligjore dhe theksoi se formulimi në to ishte identik. Prandaj nuk kishte çështje mospërputhshmërie që do të kërkonte interpretim nga Gjykata Kushtetuese. Në opinion thuhej më tej se sipas dispozitave kushtetuese nuk parashihet mundësia që Kuvendi me rezolutë të kërkonte nga Qeveria iniciimin e procedurës në Gjykatën Kushtetuese.
22. Së fundi, në opinion thuhej se sipas Kushtetutës dhe nenit 9 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, Ligji Nr. 03/L-111, ndjekja penale nuk do të ndalohej, pezullohet apo vonohet në asnjë mënyrë kur një i dyshuar është anëtar i Kuvendit të Kosovës. Në Opinion thuhej më tej që: “Ligji lejohet ta ndjekë rrugën e tij duke vazhduar hetimin dhe gjykimin”. Mandati i deputetit përfundon para kohe pas dënimit të plotfuqishëm dhe shqiptimit të dënimit prej një ose më tepër vjet burg dhe kjo mund të shpjerë në arrestim dhe burgim.

C Përgjigja dhe komentet e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje

23. Në përgjigjen e tij në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, z. Visar Ymeri theksoi se çështja e imunitetit të deputetëve ishte mjaft mirë dhe qartë e rregulluar me dispozitat kushtetuese dhe ligjore në fuqi. Mendimi i tij ishte se deputeti nuk mund të jetë objekt i ndjekjes penale, padive civile për shkak të shprehjes së lirë të mendimeve pavarësisht formës, dhe votimit apo mosvotimit për çdo vendim që merret në Kuvend. Dispozitat kushtetuese nuk e pengojnë ndjekjen penale nga organet kompetente për të gjitha veprimet e tjera të ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësisë së tyre si deputetë.
24. Ata konsideronin se imuniteti nuk mund të shërbejë si mburojë për ata deputetë që kanë kryer vepra penale të krimit të organizuar, korrupsionit dhe vepra të tjera që dëmtojnë rënd pasurinë dhe shëndetin e qytetarëve. Qëllimi i imunitetit ishte parandalimi i pushtetit arbitrar përmbi deputetin, lirimi i deputetit nga shtrëngesat e mundshme politike dhe, mbi të gjitha, garantimi i hapësirës së domosdoshme politike të deputetit për ta kryer punën e tij të përfaqësimit të interesave dhe vullnetit të qytetarëve, pa qenë objekt i trysnisë politiko-juridike gjatë këtij përfaqësimi.
25. Ata konsideronin se ndarja e pushteteve do të duhej të garantonte autonomi të mjaftueshme për të mundësuar ushtrim të funksioneve institucionale. Imuniteti i deputetit ishte qenësor për autonominë e Kuvendit dhe prandaj ishte qenësor për rendin kushtetues dhe se imuniteti ishte i lidhur me mandatin e tij/saj gjatë gjithë kohës që ai/a jo shërbente në atë post politik.
26. Ata konsideronin se imuniteti ishte i shkurtuar në rastet në të cilat ai/a jo dyshohej ose përndiqej. Ata theksuan ligjin në lidhje me ndjekjen penale, sipas nenit 9 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, që trajtonte arrestimin pa pëlqimin e Kuvendit, për personat që kapeshin në kryerje e sipër (*in flagrante*) të një veprë të rëndë penale, që është e dënueshme me pesë ose më tepër vjet burgim.
27. Ata theksuan dispozitat e neneve 281 dhe 210 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, që lejonin arrestimin e një personi në bazë të urdhrit të gjykatës, dhe pa urdhër të gjykatës edhe nga policia ose persona të tjerë kur kapej duke kryer një vepër penale.
28. Ata thanë se neni 22 (3) i Rregullores së punës së Kuvendit parashikonte që deputeti gëzonte imunitet ndaj masave të ndalimit, të arrestit, të ndjekjes penale, përderisa Kuvendi nuk merr vendim për heqjen e imunitetit të tij. Megjithatë, kjo do të mund të konsiderohej të ishte në kundërshtim me nenin 75 (2) të Kushtetutës sepse imuniteti nuk

pengon ndjekjen penale për veprimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si deputetë.

29. Së fundi, ata theksuan se pavarësisht peshës së veprës penale, imuniteti i deputetit do të mund të hiqej pas respektimit të plotë të procedurave pas votimit nga shumica e deputetëve të Kuvendit.

D Përgjigja dhe komentet e znj. Alma Lama, deputete e Kuvendit

30. Znj. Lama theksoi se neni 75 parashikonte imunitetin e deputetëve të Kuvendit, kurse paragrafi 2 i të njëjtit nen pengonte arrestimin dhe ndalimin e deputetit gjatë kohës që ai/ajo është duke kryer detyrat e tij/saj pa pëlqimin e shumicës së të gjithë deputetëve të Kuvendit. Ajo theksoi se nuk kishte paqartësi për këto çështje.

E Përgjigja dhe komentet e z. Fatmir Limaj, deputet i Kuvendit

31. Z. Limaj theksoi se kishte një numër të çështjeve kyçe, më saktësisht, nëse në Kushtetutën e Kosovës ekzistonin dispozita lidhur me imunitetin, nëse në ligjet e Kosovës ekzistonin dispozita lidhur me imunitetin, nëse Qeveria kishte autoritet për t'iu qasur drejtpërdrejt Gjykatës Kushtetuese, dhe nëse kjo kërkesë është parashtruar brenda afateve të parapara kohore. Ai i trajtoi këto çështje në përgjigjen e tij.
32. Së pari, ai citoi nenin 75 të Kushtetutës dhe erdhi në përfundim se ky nen parashikonte që ekzistonte një dispozitë lidhur me imunitetin.
33. Së dyti, ai iu referua nenit 9 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, Ligji Nr. 03/L-111, dhe, duke vënë në pah ngjashmërinë ndërmjet tij dhe dispozitave kushtetuese, ai konkludoi që në ligjet e Kosovës ekzistonin dispozita lidhur me imunitetin.
34. Së treti, ai theksoi nenin 113 (2) të Kushtetutës, i cili i jep kompetencë Qeverisë, ndër të tjera, të ngrejë çështjet e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën. Ai theksoi se Qeveria nuk kishte identifikuar asnjë çështje të përputhshmërisë me Kushtetutën, dhe prandaj, asnjë kërkesë nuk mund të parashtrohej sipas nenit 113.
35. Ai ishte i mendimit se Kushtetuta nuk lejonte parashtrimin e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese për mendime këshillëdhënëse për çështjet që kanë të bëjnë me fushëveprimin ose zbatimin e ligjit, dhe se prandaj çdo kërkesë e tillë ishte ultra vires Kushtetutës. Ai ishte i mendimit se kërkesa e parashtruar sipas nenit 93 (10) të Kushtetutës u nënshtrohej dispozitave të nenit 113 të Kushtetutës dhe se Qeveria nuk kishte qasje të posaçme në Gjykatë jashtë nenit 113 të Kushtetutës.
36. Së katërti, ai theksoi se dispozitat e neneve 29 dhe 30 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Ligji Nr. 03/L-121, përcaktonin që kërkesat e ngritura sipas nenit 113 (2) të Kushtetutës duhej të parashtroheshin brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar. Pasi Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit hyri në fuqi më 4 qershor 2010, çdo kontestim i atij Ligji duhej të parashtrohej më së voni deri më 3 dhjetor 2010.
37. Përveç kësaj, z. Limaj tërhoqi vërejtjen se për ta baraspeshuar administrimin e drejtësisë, Kushtetuta ka paraparë se deputetet nuk do të ishin mbi ligjin por se ata nuk të duhet t'i nënshtroheshin përndjekjeve të motivuara politikisht vetëm për shkak se ishin zyrtarë të zgjedhur. Ai gjithashtu theksoi se ndjekja penale nuk do të pezullohej vetëm për shkak se i dyshuari është deputet i Kuvendit dhe se hetimet dhe gjykimi do të mund të zhvilloheshin.

F Përgjigja shtesë dhe komentet e Kryetarit të Kuvendit, dr. Jakup Krasniqi

38. Përgjigja shtesë dhe komentet e dr. Jakup Krasniqit, Kryetar i Kuvendit, të 13 shtatorit 2011, pasqyrojnë ngushtë argumentet e z. Limaj të cekura më sipër.

Objekti i çështjes

39. Objekti i çështjes së kërkesës ka të bëjë me imunitetin. Pyetjet parashtuar Gjykatës Kushtetuese janë me sa vijon:

A Imuniteti i deputetëve të Kuvendit

- 1. Qeveria e Republikës së Kosovës i referon për interpretim Gjykatës Kushtetuese zbatueshmerinë dhe efektin e nenit 75 (1) (Imuniteti) të Kushtetutës së Kosovës që përcakton: “1. Deputetët e Kuvendit gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për veprimet dhe vendimet e tyre brenda fushëveprimit të përgjegjësisë të tyre si deputetë të Kuvendit. Imuniteti nuk pengon ndjekjen penale të deputetëve të Kuvendit për veprimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësisë së tyre si deputetë të Kuvendit”. Nga Gjykata Kushtetuese kërkohet të sqarojë se a gëzojnë imunitet deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës nga ndjekja penale, paditë civile, shkarkimi dhe arrestimi apo ndalimi, për veprimet dhe vendimet e tyre të ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësisë të tyre si deputetë?*
- 2. Qeveria e Republikës së Kosovës i referon për interpretim Gjykatës Kushtetuese zbatueshmerinë dhe efektin e nenit 75 (2) (Imuniteti) të Kushtetutës së Kosovës që përcakton: “2. Deputeti i Kuvendit nuk mund të arrestohet dhe as ndalohet përderisa është duke kryer detyrat e tij/saj si deputet i Kuvendit, pa pëlqimin e shumicës së të gjithë deputetëve të Kuvendit”. Nga Gjykata Kushtetuese gjithashtu kërkohet të interpretojë domethënien e “përderisa është duke kryer detyrat e tij/saj si deputet i Kuvendit”, që përmendet në nenin 75.2. A përfshin kjo kryerje vetëm ato detyra të deputetëve të ndërmarra në përmbushje të mandatit të tyre si deputetë të Kuvendit?*
- 3. Qeveria e Republikës së Kosovës i referon për interpretim Gjykatës Kushtetuese zbatueshmerinë dhe efektin e nenit 75 të Kushtetutës së Kosovës i cili përcakton: “Imuniteti nuk pengon ndjekjen penale të deputetëve të Kuvendit për veprimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësisë të tyre si deputetë të Kuvendit”. Si duhet të zbatohet neni 75 në rastet kur dyshohet për krime të kryera para fillimit të mandatit të një deputeti të Kuvendit apo për krime të kryera gjatë mandatit por që janë jashtë fushëveprimit të përgjegjësisë të tyre?*

B Imuniteti i Presidentit të Republikës

Qeveria e Republikës së Kosovës i referon për interpretim Gjykatës Kushtetuese zbatueshmerinë dhe efektin e nenit 89 (Imuniteti) të Kushtetutës së Kosovës që përcakton: “Presidenti i Republikës së Kosovës gëzon imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për veprimet dhe vendimet brenda fushëveprimit të përgjegjësisë të Presidentit të Republikës së Kosovës”. Nga Gjykata Kushtetuese kërkohet të sqarojë se a gëzon imunitet Presidenti nga ndjekja penale, paditë civile, shkarkimi dhe arrestimi apo ndalimi për veprimet

dhe vendimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të Presidentit të Republikës së Kosovës?

C Imuniteti i anëtarëve të Qeverisë

Qeveria e Republikës së Kosovës i referon për interpretim Gjykatës Kushtetuese zbatueshmerinë dhe efektin e nenit 98 (Imuniteti) të Kushtetutës së Kosovës që përcakton: “Anëtarët e Qeverisë së Kosovës gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi për veprimet dhe vendimet brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si anëtarë të Qeverisë”. Nga Gjykata Kushtetuese kërkohet të sqarojë se a gëzojnë imunitet anëtarët e Qeverisë së Republikës së Kosovës nga ndjekja penale, paditë civile, shkarkimi dhe arrestimi apo ndalimi për veprimet dhe vendimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si anëtarë të Qeverisë?

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

40. Qeveria e bazon kërkesën e vet drejtuar Gjykatës Kushtetuese në nenin 93 (10) dhe nenin 113 (3) (1), të Kushtetutës. Sipas nenit 93 (10) të Kushtetutës, Qeveria mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese. Nëse çështjet janë çështje kushtetuese, atëherë Qeveria do të jetë palë e autorizuar dhe kërkesa do të jetë e pranueshme. Gjykata do t'i shqyrtojë hollësisht këto çështje për të parë nëse kërkesa përmban çështje kushtetuese.
41. Sipas Kushtetutës, sovraniteti i Republikës së Kosovës që buron nga populli dhe që i takon popullit ushtrohet, ndër të tjera, nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur. (Shih nenin 2 të Kushtetutës). Kushtetuta u jep deputetëve të Kuvendit status të posaçëm me imunitet, siç përcaktohet në nenin 75. Ky është një instrument i rëndësishëm që e lejon pushtetin legjislativ, Kuvendin, të jetë i pavarur, i ndarë dhe i barabartë me pushtetet e tjera të shtetit.
42. Neni 89 i Kushtetutës i jep imunitet edhe Institucionit të Presidentit. Ky status dhe privilegj i posaçëm buron nga fakti që Presidenti përfaqëson unitetin e popullit dhe është kreu i shtetit. Ky institucion i shtetit, pra Presidenti i Republikës, duhet të ketë status, imunitet dhe privilegj të posaçëm për t'i kryer funksionet e veta në mënyrë të pavarur, me dinjitet dhe efikasitet, dhe në të njëjtën kohë, të mos pengohet nga pushtetet e tjera – legjislativi, ekzekutivi dhe gjyqësori.
43. Qeveria, si bartëse e degës ekzekutive, gjithashtu duhet të jetë e pavarur me funksione të definuara në mënyrë të qartë dhe të jetë e ndarë nga legjislativi dhe gjyqësori. Prandaj, Kushtetuta u jep imunitet anëtarëve të Qeverisë për ta siguruar pavarësinë dhe efikasitetin e tyre dhe për t'i mbrojtur nga ndërhyrjet e degëve të tjera.
44. Republika e Kosovës definohet nga Kushtetuta e vet si Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre. Ndarja e pushteteve është njëra prej bazave që garanton funksionim demokratik të shtetit. Esenca e funksionimit të pavarur dhe efektiv të këtyre degëve është imuniteti që u është dhënë njerëzve që i mishërojnë këto pushtete.
45. Siç thotë Kryeministri, çështjet e ngritura për imunitet ndikojnë në funksionimin demokratik të shtetit.
46. Këto çështje janë të një natyre kushtetuese pasi janë të lidhura me formën e qeverisjes së shtetit. Ato kanë të bëjnë me mekanizmat për ndarjen e pushtetit në Republikën e Kosovës.

47. Sipas Kushtetutës, ata që e zbatojnë pushtetin dhe që i ushtrojnë detyrat në shtet gëzojnë imunitet dhe status të posaçëm për ta siguruar pavarësinë e tyre në mënyrë që të mund ta kryejnë punën e tyre me efikasitet për të siguruar që pushtetet e tjera pengohen për të ndërhyrë në punën e tyre dhe për ta parandaluar abuzimin.
48. Deputetët duhet të jenë të lirë për ta ushtruar funksionin e tyre dhe të mos jenë përgjegjës për veprimet, vendimet, votimet dhe mendimet e tyre të shprehura gjatë kohës që janë duke kryer detyrat si deputetë të Kuvendit. Ajo liri, e garantuar me imunitet, shërben për t'u mundësuar deputetëve që ta ushtrojnë mandatin e tyre përfaqësues dhe ta shprehin vullnetin dhe sovranitetin e popullit. Ka rrezik që Kuvendi nuk mund të jetë në gjendje të funksionojë siç duhet pa këtë liri. Ata gëzojnë imunitet për veprimet dhe vendimet e tyre brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si deputetë. Është me rëndësi të vihet në pah se ky privilegj nuk u është dhënë deputetëve për interesin e tyre personal, por të mirën e popullit që e kanë zgjedhur atë. Ky është pasqyrim i domethënies së imunitetit që përfshin veprimet "brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si deputetë të Kuvendit".
49. Në mënyrë që kërkesa të shpallet e pranueshme, Kushtetuta kërkon që çështja t'i referohet Gjykatës në mënyrë ligjore nga një palë e autorizuar, sipas nenit 113 (1) të Kushtetutës. Gjykata gjen që pyetjet e parashtruesit janë të ngritura në mënyrë ligjore. Gjykata Kushtetuese, si autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës, konsideron se çështjet që kanë të bëjnë me imunitetin janë të një natyre kushtetuese. Prandaj, Qeveria ka ngritur çështje kushtetuese dhe është palë e autorizuar.
50. Çështjet e ngritura janë çështje kushtetuese, siç përcaktohet në nenin 93 (10) të Kushtetutës. Prandaj, nuk është e nevojshme që kërkesa të shqyrtohet në kuptim të nenit 113 (3) (1) të Kushtetutës. Për më tepër, ndonëse Kreu III, Procedurat e veçanta, i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese parashikon afate kohore për parashtrimin e kërkesave sipas nenit 113 të Kushtetutës, për parashtrimin e kërkesave të tilla nuk ka afate kohore sipas nenit 93 (10).

Meritat

51. Gjykata do t'i interpretojë dhe sqarojë çështjet kushtetuese të parashtruara nga Qeveria sipas këtij rendi: A – Imuniteti i deputetëve të Kuvendit; B – Imuniteti i Presidentit të Republikës; dhe C – Imuniteti i anëtarëve të Qeverisë.

A Lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit

Parimet përgjithshme

52. Me rastin e shqyrtimit të çështjeve kushtetuese të ngritura nga Qeveria – imuniteti i deputetëve të Kuvendit të Kosovës – Gjykata do ta shqyrtojë Kushtetutën në tërësi, e jo vetëm nenin 75, i cili thotë:

"1. Deputetët e Kuvendit gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për veprimet dhe vendimet e tyre brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si deputetë të Kuvendit. Imuniteti nuk pengon ndjekjen penale të deputetëve të Kuvendit për veprimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si deputetë të Kuvendit.

2. Deputeti i Kuvendit nuk mund të arrestohet dhe as ndalohet përderisa është duke kryer detyrat e tij/saj si deputet i Kuvendit, pa pëlqimin e shumicës së të gjithë deputetëve të Kuvendit".

53. Sipas teorisë dhe praktikës kushtetuese, sistemet e ndryshme juridike njohin dhe zbatojnë dy kategori, ose anë, të konceptit të imunitetit parlamentar.
54. Kategoria e parë është lirimi nga përgjegjësia në procedura gjyqësore të çfarëdo natyre mbi pikëpamjet e shprehura, mënyrën e votimit apo vendimet e marra gjatë punës së tyre si deputetë dhe veprimet e tjera të ndërmarra gjatë kohës që janë duke kryer detyrat e tyre. Ky lloj imuniteti vazhdon edhe pasi mandati i tyre të mbarojë dhe ka kohëzgjatje të pakufizuar. Ata kurrë nuk do të jenë të detyruar t'i përgjigjen askujt apo ndonjë gjykate për veprime dhe vendime të tilla. Kjo është përcaktuar në mënyrë të qartë në Kushtetutën e Kosovës. Ky është imunitet funksional.
55. Kategoria e dytë e imunitetit parlamentar ka të bëjë me paprekshmëri për veprimet jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si deputetë të Kuvendit. Kjo ka dy aspekte:

Ndjekja penale

- a) Aspekti i parë ka të bëjë me ndjekjen penale të deputetëve me pëlqimin e Kuvendit. Megjithatë, kjo nuk parashihet në Kushtetutën e Kosovës. Kushtetuta lejon ndjekjen penale pa pëlqimin e Kuvendit për veprimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre. (Shih nenin 75 (1), fjalinë e dytë)

Arrestimi dhe ndalimi

- b) Aspekti i dytë i referohet lirisë nga arrestimi dhe ndalimi. Privimi i lirisë mund të ndodhë me ose pa pëlqimin e Kuvendit. Gjykata Kushtetuese do t'i shtjellojë këto dy aspekte më tej në Aktgjykim.

Zbatueshmëria e këtyre parimeve të përgjithshme në Republikën e Kosovës

56. Qeveria shtron pyetjen nëse deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile, shkarkimi dhe arrestimi apo ndalimi, për veprimet dhe vendimet e tyre të ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si deputetë. Gjykata vëren që Qeveria pyet:
- a) nëse deputeti gëzon imunitet nga ndjekja penale për veprimet dhe vendimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tij/saj;
- b) nëse deputeti gëzon imunitet nga paditë civile për veprimet dhe vendimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tij/saj;
- c) nëse deputeti gëzon imunitet nga shkarkimi për veprimet dhe vendimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tij/saj; dhe
- d) nëse deputeti gëzon imunitet nga arrestimi dhe ndalimi për veprimet dhe vendimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tij/saj.
57. Sa i përket veprimit brenda fushëveprimit të përgjegjësive të deputetëve, duhet të theksohet që deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës gëzojnë imunitet funksional. Kjo do të thotë se ata gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi për veprimet dhe vendimet e tyre. (Shih nenin 75 (1), fjalinë e parë).
58. Neni 75 (1) i Kushtetutës përcakton që deputetët e Kuvendit të Kosovës gëzojnë imunitet funksional lidhur me mendimet e shprehura, mënyrën e votimit, ose veprimet apo vendimet e ndërmarra brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si deputetë. Vërtet, për shkak të karakteristikave dhe rëndësisë së të drejtave dhe detyrave të deputetëve, ata kanë pozitë të privilegjuar brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre. Për shkak të këtij

statusi të posaçëm, si përfaqësues të zgjedhur që kryejnë mandatin e tyre kushtetues, ata gëzojnë imunitet i cili u mundëson liri, siguri dhe pavarësi më të madhe nga ekzekutivi dhe gjyqësori, por vetëm deri në masën që veprimet dhe vendimet e tyre ndërmerren brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre.

59. Kushtetuta përcakton në mënyrë të qartë fushëveprimin e përgjegjësive të deputetëve. Ato janë veprime dhe vendime që ndërmerren për t'i kryer kompetencat e Kuvendit të Kosovës, të përcaktuara në nenin 65 të Kushtetutës. Si rrjedhojë, deputetët gëzojnë imunitet për veprimet ose vendimet e ndërmarra që kanë të bëjnë me:

- (1) miratimin e ligjeve, rezolutave dhe akteve të tjera të përgjithshme;*
- (2) vendimin për ta ndryshuar Kushtetutën me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve që mbajnë vendet e rezervuara dhe të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë;*
- (3) shpalljen e referendumit, në pajtim me ligjin;*
- (4) ratifikimin e traktateve ndërkombëtare;*
- (5) miratimin e Buxhetit të Republikës së Kosovës;*
- (6) zgjedhjen dhe shkarkimin e Kryetarit dhe të nënkryetarëve të Kuvendit;*
- (7) zgjedhjen dhe shkarkimin e Presidentit të Republikës së Kosovës në pajtim me këtë Kushtetutë;*
- (8) zgjedhjen e Qeverisë dhe shprehjen e mosbesimit ndaj saj;*
- (9) mbikëqyrjen e punës së Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit;*
- (10) zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë;*
- (11) propozimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese;*
- (12) mbikëqyrjen e politikës së jashtme dhe të sigurisë;*
- (13) dhënien e pëlqimit për dekretin e Presidentit mbi shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme;*
- (14) vendosjen për çështjet me interes të përgjithshëm, të përcaktuara me ligj.*

60. Me këtë rast, deputetët janë të obliguar ta ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me Kushtetutën, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit (Shih nenin 74 të Kushtetutës).
61. Si rrjedhojë, për të siguruar ndarje të pushteteve dhe funksionim të pavarur të Kuvendit, të lirë nga ndërhyrja e pushtetit ekzekutiv apo gjyqësor në fushën legjislativë, deputetët e Kuvendit të Kosovës gëzojnë imunitet funksional dhe lirohen nga përgjegjësia për veprimet dhe vendimet e ndërmarra brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre.
62. Në një sërë rastesh, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut e trajtoi zbatueshmërinë e liritë nga përgjegjësia të anëtarëve të parlamenteve në shtetet nënshkruese përballë Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore dhe Protokollet lidhur me to.
63. Për shembull, në rastin Syngelidis kundër Greqisë (Kërkesa nr. 24895/07), të 11 shkurtit 2010, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut theksoi:

“41...E drejta për qasje në gjykatë zvogëlohet kur rregullat pushojnë t'u shërbejnë qëllimeve të sigurisë ligjore dhe administrimit të mirëfilltë të drejtësisë dhe formojnë një lloj pengese duke ia pamundësuar palës ndërgjyqëse që rasti i tij/i saj të zgjidhet në bazë të meritave nga gjykata kompetente.

42. Gjykata vëren në lidhje me këtë se kur shteti u jep imunitet anëtarëve të vet të parlamentit, mbrojtja e të drejtave themelore mund të dëmtohet. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që imuniteti parlamentar mund të konsiderohet si parim i imponimit të një kufizimi të pabarabartë për të drejtën për qasje në Gjykatë, siç ceket në nenin 6, paragrafin 1 (shih Kart kundër Turqisë, cituar më lart, paragrafi 80). Siç është e drejta e qasjes në Gjykatë pjesë e pandashme e garancisë për gjykim të drejtë sipas atij neni, edhe disa kufizime për qasjen duhet të trajtohen po ashtu si pjesë të pandashme, shembull i kësaj janë kufizimet në përgjithësi të pranuar nga shtetet nënshkruese si pjesë e doktrinë së imunitetit parlamentar (shih A. kundër Mbretërisë së Bashkuar, cituar më lart, paragrafi 83, dhe, mutatis mutandis, Al-Adsani kundër Mbretërisë së Bashkuar [DHM], nr. 35763/97, paragrafi 56, GJEDNJ 2001-XI). Gjykata tashmë ka pranuar se është praktikë e gjatë që shtetet në përgjithësi u caktojnë parlamentarëve shkallë të ndryshme të imunitetit, me synimin që përfaqësuesve të popullit t'u lejohet fjala e lirë dhe që të pengohet ndërhyrja mbi bazat partizane në funksionet parlamentare. (shih A. kundër Mbretërisë së Bashkuar, cituar më lart, paragrafët 75-77; Cordova, cituar më lart, paragrafi 55, dhe De Jorio kundër Italisë, nr. 73936/01, paragrafi 49, 3 qershor 2004). Prandaj, krijimi i përjashtimeve për atë imunitet, zbatimi i të cilave varet nga faktet individuale të ndonjë rasti të veçantë, do ta dëmtonte rënd synimin legjitim të ndjekur (shih A. kundër Mbretërisë së Bashkuar, cituar më lart, paragrafi 88).

43. Megjithatë, kjo nuk do të ishte në përputhje me qëllimin dhe synimin e Konventës nëse shtetet nënshkruese, duke miratuar njërin prej sistemeve të imunitetit parlamentar që zakonisht përdoret, do të liroheshin nga të gjitha përgjegjësitë sipas Konventës në lidhje me veprimtarinë parlamentare. Duhet të kihet parasysh që qëllimi i Konventës nuk është garantimi i të drejtave që janë teorike ose iluzore, por i të drejtave që janë praktike dhe efektive. Kjo vlen posaçërisht për të drejtën për qasje në Gjykatë në kuptim të vendit të rëndësishëm që ka e drejta për gjykim të drejtë (shih Ait-Mouhoub kundër Francës, 28 tetor 1998, paragrafi 52, Raportet 1998-VIII). Nuk do të ishte në përputhje me sundimin e ligjit në një shoqëri demokratike ose me parimet themelore që përfshihen në nenin 6, paragrafin 1, nëse shteti, pa kufizim ose kontroll nga Gjykata, do të mund ta hiqte nga kompetenca e gjykatave një gamë të tërë të padive civile apo t'u jepte imunitete kategorive të personave (shih Fayed kundër Mbretërisë së Bashkuar, 21 shtator 1994, paragrafi 65, Seria A, nr. 294-B).

44. Prandaj, në rastet në të cilat imuniteti e pengon ushtrimin e të drejtës për qasje në gjykatë, me rastin e përcaktimit nëse masa e posaçme ishte apo nuk ishte proporcionale, Gjykata shqyrton nëse aktet e kundërshtuara ishin të lidhura me ushtrimin e funksioneve parlamentare në kuptimin e tyre të ngushtë (shih Cordova (nr. 1), cituar më lart, paragrafi 62, dhe De Jorio, cituar më lart, paragrafi 53). Gjykata përsërit se mungesa e cilësdo lidhje të qartë me veprimtarinë parlamentare kërkon që ajo ta përvetësojë një interpretim të ngushtë të konceptit të proporcionalitetit ndërmjet synimit që kërkohet të arrihet dhe mjeteve të zbatuara. Kjo është pikërisht kështu në rastet në të cilat kufizimi i të drejtës së qasjes buron nga vendosmëria e një organi politik (shih Kart kundër Turqisë, cituar më lart, paragrafi 83, dhe Tsalkitzis kundër Greqisë, nr. 11801/04, paragrafi 49, 16 nëntor 2006). Për më tepër, sa më i gjerë që të jetë imuniteti, arsyetimi i tij duhet të jetë edhe më bindës (shih A. kundër Mbretërisë së Bashkuar, cituar më lart, paragrafi 78)."

Përgjigjet në katër pjesët e pyetjes së parë të Qeverisë lidhur me imunitetin e deputetëve

64. Gjykata rikujton që Qeveria pyeti nëse deputetët e Kuvendit gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile, shkarkimi dhe arrestimi apo ndalimi për veprimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive së tyre. Gjykata do të përgjigjet në secilën pyetje.

a) Imuniteti nga ndjekja penale për veprimet dhe vendimet jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të deputetëve.

65. Fjala e dytë e nenit 75 (1) të Kushtetutës parashikon kufizim për imunitetin e përgjithshëm që u jepet deputetëve, “Imuniteti nuk pengon ndjekjen penale të deputetëve të Kuvendit për veprimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive së tyre si deputetë të Kuvendit”. Kushtetuta bën dallim të qartë ndërmjet asaj që deputeti bën si përfaqësues i popullit dhe asaj që ai/ajo bën në jetën e vet private. Në Kushtetutë nuk ka imunitet bllanko që jepet për të gjitha ndjekjet penale.

66. Në cilësinë e tyre si qytetarë të rëndomtë, sipas Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, deputetët trajtohen njëloj si të gjithë qytetarët e tjerë. Ky konkluzion buron nga fjalia e dytë e nenit 75 (1) të Kushtetutës, i cili përcakton që imuniteti nuk pengon ndjekjen penale të deputetëve të Kuvendit për veprimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive së tyre si deputetë të Kuvendit.

67. Kjo forcohet edhe më tej kur të kihet parasysh neni 70 (6) i Kushtetutës, i cili përcakton që mandati i deputetit mbaron nëse deputeti dënohet për vepër penale me një ose më shumë vjet burgim me një vendim gjyqësor të formës së prerë.

68. Kushtetuta nuk lejon kufizim ose ndërhyrje nga legjislativi në ndjekjen penale të deputetëve të Kuvendit për veprimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive së tyre.

69. Pasi Kushtetuta nuk garanton paprekshmëri lidhur me ndjekjen penale të deputetëve të Kuvendit për veprimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive së tyre, ata nuk janë të paprekshëm as lidhur me ndjekjen penale për veprat penale të cilat pretendohen të jenë kryer para fillimit të mandatit të tyre si deputetë ose gjatë rrjedhës së mandatit të tyre.

70. Neni 22 (3) i Rregullores së punës së Kuvendit përcakton që “Deputeti gëzon imunitet ndaj ... ndjekjes penale, përderisa Kuvendi nuk merr vendim për heqjen e imunitetit të tij”. Gjykata Kushtetuese vëren që kjo dispozitë, lidhur me ndjekjen penale, është pa vlerë juridike pasi në Kushtetutë nuk ka imunitet të tillë ndaj ndjekjes penale të deputetit. Gjykata përsërit edhe një herë se nuk ekziston imunitet që e pengon ndjekjen penale të deputetëve për veprimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive së tyre. Nuk nevojitet vendimi i Kuvendit për një ndjekje të tillë penale.

71. Rrethana e vetme kur kërkohet vendimi i Kuvendit për heqjen e imunitetit ka të bëjë me arrestimin ose ndalimin e deputetit kur ai/ajo është duke kryer detyrat e tij/saj si deputet. Ky është qëndrim kushtetues.

b) Imuniteti nga paditë civile për veprimet dhe vendimet jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre.

72. Nuk ka pengesë kushtetuese për ngritjen e padive të tilla civile. Kjo buron nga gjuha e qartë që ka të bëjë me imunitetin funksional. Është e qartë se dispozitat përkatëse të ligjeve në fuqi do të zbatohen në një situatë të tillë.

c) Imuniteti nga shkarkimi për veprimet dhe vendimet jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre.

73. Interpretimi i shkarkimit në këtë kontekst nënkupton largimin e deputetit nga posti i anëtarit të Kuvendit. Neni 70 i Kushtetutës e rregullon fushëveprimin, kohëzgjatjen dhe mundësinë që mandati i deputetit të mbarojë ose të bëhet i pavlefshëm. Këto dispozita nuk ofrojnë argumente për të konkluduar që deputeti mund të shkarkohet për veprimet jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tij. Kjo do të thotë që kjo dispozitë duhet të lexohet ashtu që t'u referohet rasteve të mbarimit të mandatit kur deputeti dënohet për vepër penale me një ose më shumë vjet burgim me një vendim gjyqësor të formës së prerë.

d) Imuniteti nga arrestimi dhe ndalimi për veprimet dhe vendimet jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre.

74. Imuniteti nga arrestimi dhe ndalimi gjithashtu duhet të lexohet në lidhje me pyetjen e dytë të Qeverisë dhe Gjykata do t'u përgjigjet bashkërisht.
75. Qeveria kërkoi interpretimin e shprehjes “*përderisa është duke kryer detyrat e tij/saj si deputet i Kuvendit*”, të përcaktuar në nenin 75 (2) të Kushtetutës.
76. Kushtetuta garanton barazinë para ligjit dhe çdokush gëzon të drejtën për mbrojtje të barabartë ligjore. Prandaj, Kushtetuta parashikon që drejtësia të ndahet e jo të vonohet. Kjo vlen edhe për deputetët në cilësinë e tyre si qytetarë të rëndomtë. Ata mund të ndiqen penalisht dhe janë përgjegjës për veprimet jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si deputetë, si për veprimet para ashtu edhe për ato të kryera gjatë mandatit të tyre.
77. Kuptohet vetvetiu që deputetët, sikur të gjithë personat e tjerë që janë nën juridiksionin e gjykatave në Republikës së Kosovës, kanë të drejtë për mbrojtje të të drejtave dhe lirive të tyre themelore të garantuara me Kushtetutë dhe ligj. Këtu përfshihen të drejtat e përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] në kuptim të nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] që të dytë në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së, dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]. Deputetët, siç është rasti me të gjithë qytetarët, gjithashtu kanë të drejtë për procedura të ndershme gjyqësore të garantuara me Kushtetutë dhe ligj, duke përfshirë fazën e procedurës paraprake. Gjykata gjithashtu thekson se neni 19 i Kushtetutës, lidhur me zbatimin e normave juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare, mund të merret parasysh.
78. Në rrethana të tilla, siç parashihet në nenin 29 të Kushtetutës, masa e “privimit të lirisë”, e cila përfshin masën e “arrestimit ose përndryshe ndalimit”, mund t'i shqiptohet deputetit në rastet e parapara me ligj dhe pas një vendimi të gjykatës kompetente në situatat e përmendura në nenin 29 të Kushtetutës.
79. Gjykata rikujton se neni 29 (1) i Kushtetutës [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] thotë me sa vijon:

1. Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, si në vijim:

- (1) pas shpalljes së dënimit me burgim për kryerjen e veprës penale;
- (2) për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një veprë tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjyqimit në mënyrën e përcaktuar me ligj;
- (3) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij/saj në një institucion kompetent, sipas një urdhri të ligjshëm;
- (4) për mbikëqyrje shëndetësore të personit, i cili për shkak të sëmundjes paraqet rrezik për shoqërinë;
- (5) për hyrje të paligjshme në Republikën e Kosovës ose pas urdhrit të ligjshëm për largim ose ekstradim”.

80. Gjykata gjithashtu vëren që neni 29 (2) i Kushtetutës përcakton që në rastet kur arrestimi ose ndalimi bëhet pa urdhër të gjykatës, personi i privuar duhet të dërgohet përpara gjyqtarit brenda dyzet e tetë (48) orësh, i cili vendos për paraburgimin ose lirimin e tij/saj, jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë nga momenti kur personi i privuar është sjellë para gjykatës.
81. Mbikëqyrja e lirisë personale të garantuar me Kushtetutë u është besuar të gjitha organeve për zbatimin e ligjit, organeve të ndjekjes penale dhe gjykatave, sipas ligjit në fuqi.
82. Neni 5 i KEDNJ-së, që trajton të drejtën e lirisë, përcakton që personi mund t'i nënshtrohet arrestimit apo ndalimit të ligjshëm vetëm në rrethana të përcaktuara qartë. Këtu përfshihen çështje të tilla si burgosja pas shqiptimit të dënimit dhe arrestimi nën dyshimin për kryerje të krimit. Në veçanti, neni 5 parashikon të drejtën për qasje pa vonesë në gjykatë ose në procedura përkatëse gjyqësore për ta përcaktuar ligjshmërinë e arrestimit apo ndalimit dhe për gjykim brenda një afati të arsyeshëm ose për lirim deri në gjykim.
83. Dispozitat e nenit 5 të KEDNJ-së janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë në bazë të nenit 22 të Kushtetutës dhe kanë përparësi në rast të konfliktit me ligjin vendës. Neni 54 i Kushtetutës i jep fuqi ligjore Konventës duke siguruar që çdokush, duke përfshirë deputetët e Kuvendit, gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore dhe të drejtën në mjete efektive juridike nëse konstatohet se një e drejtë e tillë ose liri themelore është shkelur.
84. Dispozitat dhe garancitë e njëjta të përgjithshme që kanë të bëjnë me arrestimin dhe ndalimin dhe gjykimin e drejtë nuk zbatohen vetëm në hetime penale dhe gjykime, por edhe në padi civile.

Dispozitat kushtetuese dhe ligjore lidhur me arrestimin dhe ndalimin e deputetëve të Kuvendit të Kosovës

85. Arrestimi dhe ndalimi i deputetit parashikohet me dispozita të Kushtetutës dhe me Ligjin për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit. Dispozitat në vijim lejojnë këtë:

- Kushtetuta
- i. Kuvendi ia heq imunitetin nga arrestimi ose ndalimi tjetër një deputeti gjatë kohës që është duke kryer detyrat e tij/saj në përputhje me nenin 72 (2) i cili thotë:

“2. Deputeti i Kuvendit nuk mund të arrestohet dhe as ndalohet përderisa është duke kryer detyrat e tij/saj si deputet i Kuvendit, pa pëlqimin e shumicës së të gjithë deputetëve të Kuvendit.”

- Kushtetuta
- ii. Kur deputeti nuk është duke kryer detyrat. Kjo buron nga neni 75 (2) i Kushtetutës.

- Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit
- iii. Neni 9 (9) i Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit posaçërisht parashikon që deputeti mund të arrestohet nëse kapet në kryerje e sipër (*in flagrante*) të një veprë të rëndë penale, që është e dënueshme me pesë ose më shumë vjet burgim. Paragrafët 2 dhe 9 të nenit 9 të këtij Ligji parashikojnë:

2. Deputeti i Kuvendit nuk mund të arrestohet dhe as të ndalohet përderisa është duke i kryer detyrat e tij/saj si deputet i Kuvendit, pa pëlqimin e shumicës së të gjithë deputetëve të Kuvendit.

....

*9. Përjashtimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, masa e paraburgimit mund të ndërmerret ndaj deputetit pa pëlqimin paraprak të Kuvendit, në rastin kur ai ose ajo kapet në kryerje e sipër (*in flagrante*) të një veprë të rëndë penale, që është e dënueshme me pesë (5) ose më shumë vjet burgim.*

- Kushtetuta
- iv. Mandati mbaron për shkak të dënimit me një ose më shumë vjet burgim me një vendim gjyqësor të formës së prerë, dhe arrestimi mund të ndodhë pa iu referuar asnjë personi ose organi tjetër pasi më nuk ekziston mbrojtje kushtetuese.

86. Në rrethanën e parë me të cilën parashikohet arrestimi ose ndalimi i deputetit, Kushtetuta qartazi përcakton rrethanat që duhet të ekzistojnë në mënyrë që arrestimi ose ndalimi i deputetit të mund të ndodhë. Shprehja kushtetuese “*përderisa është duke kryer detyrat e tij/saj*” kërkon interpretim nga Gjykata jo vetëm për shkak të pyetjes së parashtruar, por për shkak se është me rëndësi të jepet përgjigja në pyetjet e ngritura lidhur me funksionimin e Kuvendit.
87. Në nenin 66 të Kushtetutës përdoret shprehja “mandat” për ta përshkruar kohëzgjatjen e legjislaturës përkatëse. Në të thuhet që mandati katërvjeçar fillon me seancën konstituive të mbajtur pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve dhe përfundon me shpërndarjen e Kuvendit.
88. Kushtetuta gjithashtu përdor shprehjen “mandat” në lidhje me deputetët e Kuvendit me ç’rast ata, si përfaqësues të popullit, nuk i nënshtrohen asnjë mandati detyrues. Secili deputet ka mandat individual, i cili fillon në ditën e certifikimit të rezultatit të zgjedhjes. Në ndërkohë që mandati i Kuvendit fillon me seancën konstituive të Kuvendit të sapozgjedhur, mandati i deputetit mund të fillojë më herët. Mandati i deputetit mbaron me shfaqjen e cilësdo prej rrethanave të cekura në nenin 70 (3) të Kushtetutës. Mandati i deputetit mishëron funksionin e tij/saj përfaqësues.
89. Kuvendi i zhvillon punimet vjetore në dy sesione. Ato fillojnë të hënën e tretë të muajit janar dhe të hënën e dytë të muajit shtator dhe përfundojnë në kohën kur Kuvendi të vendosë.

90. Neni 40 i Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit përcakton që deputetët janë të detyruar të marrin pjesë në seancat plenare dhe në mbledhjet e organeve ndihmëse të Kuvendit, në të cilat ai është anëtar.
91. Neni 39 i Rregullores së punës të Kuvendit përcakton që Kuvendi i zhvillon punimet në mbledhje plenare dhe në komisione. Deputetët i kryejnë detyrat e veta në këto mbledhje dhe komisione. Me këtë rast, ata i përmbushin, ushtrojnë dhe u japin kuptim të plotë kompetencave të Kuvendit, siç përcaktohet në nenin 65. Veprimet dhe vendimet, duke përfshirë diskutimet e tyre, fjalimet dhe votimet, të gjitha ndodhin në këto mbledhje plenare dhe mbledhje të komisioneve dhe ata gëzojnë imunitet funksional për kryerjen e asaj pune. Imuniteti funksional e mbron atë punë. Ai është qëllimi i imunitetit dhe ata kurrë nuk mund të mbahen përgjegjës për atë që bëjnë në këto mbledhje.
92. Kuvendi funksionon vetëm kur mbledhet. Kryetari i Kuvendit është personi që vendos për datat e mbledhjeve. Përveç këtyre mbledhjeve të Kuvendit apo të komisioneve të tij, nuk mund të thuhet që deputetët e Kuvendit kryejnë punën e nevojshme për t'i zbatuar detyrat e Kuvendit. (Shih nenin 39 të Rregullores së punës së Kuvendit).
93. Sisteme të ndryshme juridike dhe kushtetuta në Evropë kanë përkufizime të ndryshme për mandatin dhe kohëzgjatjen e fushëveprimit dhe kohës së imunitetit të deputetit. Kjo përfshin tërë mandatin e parlamentit ose seancat e parlamentit ose mbledhjet e dhomave të parlamentit.
94. Periudha e kryerjes së detyrave të deputetit është puna e tij/saj lidhet në Kuvend gjatë mbledhjeve të Kuvendit dhe mbledhjeve të komisioneve të tij.
95. Neni 75 (2) përcakton që, në mënyrë që deputeti të arrestohet ose ndalohet gjatë kohës që është duke kryer detyrat e tij/saj, nevojitet pëlqimi i shumicës së të gjithë deputetëve të Kuvendit për t'ia hequr imunitetin. Qëllimi i këtij kriteri është të sigurohet që puna e Kuvendit nuk guxon të pengohet. Gjatë kohës që deputeti është duke kryer detyrat e tij/saj, kjo është në të mirë të Kuvendit dhe të kryerjes së punës së Kuvendit. Vendimi i Kuvendit nevojitet për ta larguar deputetin pasi prania e tij fizike është e domosdoshme në mbledhjet e Kuvendit dhe të komisioneve të tij. Gjatë punës së Kuvendit, deputeti është në cilësi të përfaqësuesit të popullit dhe pjesë përbërëse e Kuvendit. Vetëm Kuvendi është ai që mund të vendosë se deputeti mund të arrestohet dhe ndalohet gjersa është duke kryer punët e Kuvendit.
96. Gjykata përsërit se jashtë fushëveprimit të përgjegjësisë të tij/saj, deputeti duhet të trajtohet si çdo qytetar tjetër. Deputeti është përgjegjës për veprimet dhe sjelljet e veta private si të gjithë qytetarët e tjerë. Prandaj, gjatë kohës që nuk është duke i kryer detyrat e tij/saj, ai/ajo mund të arrestohet apo ndalohet pa vendim të Kuvendit sipas ligjit në fuqi. Kjo mund të ndodhë duke zbatuar dispozitat e ligjit në fuqi në Republikën e Kosovës, si për të gjithë qytetarët e tjerë. Ligji në fuqi dhe kush ka kompetencë për të urdhëruar arrestimin do të shtjellohet edhe më tej.
97. Situata që lejon arrestimin dhe ndalimin kur kapet në kryerje e sipër (*in flagrante*) të një veprë të rëndë penale, që është e dënueshme me pesë ose më shumë vjet burgim është standard i pranuar në rendin kushtetues të të gjitha vendeve, në Kushtetutën apo ligjet e tyre organike. Publiku duhet të ketë besim se interesat e tyre janë të mbrojtur në këto rrethana. Administrimi publik i drejtësisë nuk mund të pengohet vetëm për shkak të ekzistimit të perceptimit se në një fazë të një procedure penale një deputet do të mund të deklaronte se gëzonte imunitet nga ndjekja penale. Kjo do ta dëmtonte besimin në administrimin e drejtësisë. Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit e pranon këtë përjashtim në nenin 9 (9). Rasti për arrestim në rrethana të tilla është i qartë.

98. Mandati i deputetit parashihet me Kushtetutë. Megjithatë, Kushtetuta parashikon kur mandati mund të përfundojë para kohe. Në lidhje me situatën kur ekziston vendimi gjyqësor i formës së prerë me të cilin një deputet dënohet me një ose më shumë vjet burgim, deputetit i hiqet mandati dhe prandaj mandati i tij/saj përfundon dhe ai/ajo më nuk i gëzon privilegjin dhe imunitetin që shkojnë me mandat. Pas kësaj vendimi për dënim me burg mund të shqiptohet dhe mund të vijë deri tek arrestimi i tij/her në përmbushje të dënimit të gjykatës.

Organi që kërkon heqjen e imunitetit

99. Kur ndjekja penale është në proces, nëse organi i ndjekjes penale apo gjykata konsideron që heqja e imunitetit kërkohej për zhvillim të mirëfilltë të ndjekjes penale, atëherë Kuvendi duhet ta shqyrtojë kërkesën për heqje të imunitetit. Kuvendi është i obliguar me Kushtetutë që t'i shqyrtojë kërkesat për heqje të imunitetit në rastet kur kjo kërkohej. Boshllëku në ligj ose dështimi i Kuvendit për të miratuar ligje që janë të domosdoshme për të siguruar funksionim të drejtë të degës gjyqësore të pushtetit të shtetit nuk mund të përdoret si arsytim për të mos e zbatuar obligimin pozitiv për ta shqyrtuar vendimin për heqjen e imunitetit.

100. Neni 9 (3) i Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit përcakton që kërkesën për heqjen e imunitetit të deputetit e bën vetëm Prokurori i Përgjithshëm. Është e qartë se ekzistojnë edhe situata të tjera në të cilat arrestimi mund të jetë i nevojshëm, sipas mendimit të policisë, prokurorit publik, prokurorit të shtetit apo prokurorëve specialë të EULEX-it. Në rast të ngritjes së padisë private, gjykata që e shqyrton rastin duhet t'ia paraqesë Kuvendit kërkesën për heqjen e imunitetit.

101. Dështimi i Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit për të theksuar se cilido prej tyre apo i të gjithëve për të parashtruar kërkesë për heqje të imunitetit nuk e parandalon pranimin e një kërkesë të tillë. Nëse kërkesa e tillë parashtrrohet nga një organ kompetent, atëherë Kuvendi është i detyruar ta shqyrtojë atë. Çështja e miratimit ose refuzimit të kërkesës është tërësisht në përgjegjësi të Kuvendit, i cili duhet ta shqyrtojë atë.

102. Në këtë drejtim, është me rëndësi të kihet parasysh se sipas nenit 109 të Kushtetutës *“Prokurori i Shtetit është institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për ndonjë vepër penale ose për ndonjë vepër tjetër, sikurse është rregulluar me ligj”*.

103. Gjykata gjithashtu thekson që më 30 shtator 2010, Kuvendi ka miratuar *“Ligjin Nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit”*, i cili do të hyjë në fuqi më 13 janar 2013. Pas asaj date, ligjet në vijim do të shfuqizohen: *“1.1. Ligji mbi Prokurorinë Publike të Krahinës Autonome të Kosovës, 1.2. Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 1999/05, për themelimin e Gjykatës ad hoc të instancës së fundit dhe të zyrës ad hoc të Prokurorisë Publike. 1.3. Cilido ligj tjetër deri në masën që është në mospërputhshmëri me dispozitat e këtij ligji”*.

104. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, cilido referim në cilindo ligj, rregullore, urdhëresë, rregull apo ndonjë akt tjetër juridik për *“Shërbime Prokuroriale”* apo *“Prokuror Publik”* do të interpretohet që ta ketë kuptimin e *“Prokurorit të Shtetit”*. Megjithatë, asgjë në këtë ligj nuk do të interpretohet apo zbatohet për të ndryshuar, kufizuar, zgjeruar apo për të ndryshuar në ndonjë formë tjetër autoritetin, juridiksionin, pushtetin apo detyrat e caktuara të Prokurorisë Speciale të përcaktuara me Ligjin mbi Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, Nr. 2008/03-Lo52.

105. Prandaj, duket që aktet juridike që rregullojnë kompetencat dhe organizimin e prokurorëve janë: *Ligji mbi Prokurorinë Publike i Krahinës Autonome të Kosovës dhe Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 1999/05, për themelimin e Gjykatës ad hoc të instancës së*

fundit dhe të zyrës ad hoc të Prokurorisë Publike. Përveç kësaj, ekziston edhe Ligji mbi Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.

106. Gjykata gjithashtu vëren që në përputhje me Ligjin e vitit 2008 mbi Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, Prokuroria Speciale themelohet si një organ prokurorial i përhershëm dhe i specializuar që vepron në kuadër të Prokurorit të Shtetit të Kosovës. Ligji ka paraparë që gjatë kohëzgjatjes së Misionit të EULEX-it në Kosovë, Prokuroria Speciale do të përbëhet edhe nga pesë prokurorë të EULEX-it, përveç prokurorëve të paraparë me këtë Ligj.
107. Kuvendi i Republikës e miratoi Ligjin për kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë më 13 mars 2008.
108. Ligji mbi Prokurorinë Publike (Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, KSAK, Nr. 32/76, 52/77, 49 (79, 44/82, 44/84 dhe 18/87) ende është në fuqi dhe përcakton:

Sipas nenit 1, Prokuroria Publike është organ i pavarur shtetëror që i ndjek penalisht autorët e veprave penale dhe të veprave të tjera të dënueshme me ligj, merr masa në përputhje me ligjin për mbrojtjen e interesave të bashkësive shoqërore, shfrytëzimin e mjeteve juridike për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë dhe kryen detyra të tjera në përputhje me ligjin.

109. Gjykata Kushtetuese më pas vëren që ndjekja penale e personave të akuzuar për vepra penale bëhet sipas akteve të ndryshme juridike, siç përcaktohet në nenin 109 të Kushtetutës.
110. Organet që kanë të drejtë të kërkojnë që Kuvendi t'ia heqë imunitetin një deputeti gjatë kohës që ai/ajo është duke kryer detyrat e tij/saj, gjithashtu kanë të drejtë ta arrestojnë apo ndalojnë pa vendim të Kuvendit përderisa deputeti nuk është duke i kryer detyrat e tij/saj.

Procedura për heqje të imunitetit për ndalim dhe arrestim

111. Kjo procedurë nuk është posaçërisht e paraparë në Kushtetutë, por as nuk është e domosdoshme. Procedura e përcaktuar në nenin 23 të Rregullores së punës së Kuvendit duhet të përdoret në rastet ose në kërkesën për heqjen e imunitetit të deputetit lidhur me arrestimin apo ndalimin. Kjo nuk zbatohet për imunitetin nga ndjekja penale që nuk ekziston sipas Kushtetutës. Gjykata përsërit se neni 22 (3) i Rregullores së punës së Kuvendit, i cili flet për imunitetin ndaj ndjekjes penale është pa vlerë juridike kur synon të japë imunitet të tillë. Kjo procedurë shtjellohet më tej në nenin 23 të Rregullores së punës. Kjo është në përputhje me dispozitat kushtetuese vetëm deri në masën që ka të bëjë me heqjen e imunitetit lidhur me arrestimin apo ndalimin.
112. Gjithashtu duhet të theksohet se Rregullorja e punës e Kuvendit fut një procedurë të posaçme që ka të bëjë me situatën kur deputeti i Kuvendit arrestohet apo ndalohet nga organi kompetent pa heqje të imunitetit, d.m.th. pa vendim të Kuvendit. Ku arrestimi apo ndalimi bëhet pa heqje të imunitetit, ai mund të ndodhë për shkak të zhvillimit të ndjekjes penale për një krim jashtë fushëveprimit të përgjegjësive dhe jashtë kohës kur deputeti ishte duke kryer detyrat e tij/saj. Në rrethana të tilla, Kuvendi nuk mund ta hedhë poshtë vendimin gjyqësor me të cilin urdhërohet arrestimi dhe ndalimi. Çdo kompetencë që Kuvendi përpiqet t'i japë vetes për ta bërë një gjë të tillë është pa vlerë juridike dhe nuk është në përputhje me Kushtetutën. Natyrisht, deputeti ka në

dispozicion të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tij/saj, siç u cek më lart në këtë raport, dhe ka të drejtë të plotë t'u drejtohet gjykatave të Republikës së Kosovës për mbrojtjen e atyre të drejtave sipas Kushtetutës dhe ligjit.

113. Studimet krahasimtare tregojnë se është qëndrim mbizotërues se kur një deputet arrestohet duke kryer një krim të rëndë, është detyrë e organeve që e kryejnë arrestimin që ta njoftojnë udhëheqjen e Kuvendit për arrestimin që ka ndodhur. Neni 24 (1) i Rregullores së punës thotë që organi kompetent i ndjekjes e informon menjëherë Kryetarin e Kuvendit për arrestim apo ndalim. Kjo siguron funksionim të mirëfilltë të Kuvendit.

Përgjigja në pyetjen e tretë të Qeverisë në lidhje me imunitetin e deputetëve

114. Qeveria kërkon interpretim të nenin 75 të Kushtetutës në rastet kur dyshohet për krime të kryera para fillimit të mandatit të një deputeti apo për krime të kryera gjatë mandatit, por që janë jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre. Siç u cek në paragrafin 65 më lart, Kushtetuta nuk ofron imunitet lidhur me ndjekjen penale të deputetëve të Kuvendit për veprimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre. Ata mund të ndiqen penalisht për krimet që pretendohen të jenë kryer para fillimit të mandatit të tyre si deputetë. Ata mund të ndiqen penalisht edhe për krimet e kryera gjatë mandatit të tyre jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre.

B Lidhur me imunitetin e Presidentit të Republikës së Kosovës

115. Në pjesën e kërkesës së Qeverisë lidhur me imunitetin e Presidentit parashtrohen dy pyetje.

- i) Interpretimi i zbatueshmërisë dhe i efektit të nenit 89 të Kushtetutës.
- ii) Qeveria kërkon sqarim nëse Presidenti gëzon imunitet nga ndjekja penale, paditë civile, shkarkimi dhe arrestimi apo ndalimi për veprimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të Presidentit të Republikës së Kosovës.

116. Gjykata vë në pah që Qeveria kërkon sqarim lidhur me:

- a) nëse Presidenti gëzon imunitet nga ndjekja penale për veprimet dhe vendimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tij/saj;
- b) nëse Presidenti gëzon imunitet nga paditë civile për veprimet dhe vendimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tij/saj;
- c) nëse Presidenti gëzon imunitet nga shkarkimi për veprimet dhe vendimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tij/saj, dhe
- d) nëse Presidenti gëzon imunitet nga arrestimi dhe ndalimi për veprimet dhe vendimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tij/saj.

117. Neni 89 [Imuniteti] thotë:

Presidenti i Republikës së Kosovës gëzon imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për veprimet dhe vendimet brenda fushëveprimit të përgjegjësive të Presidentit të Republikës së Kosovës.

118. Ky është imunitet funksional dhe tiparet e imunitetit funksional tashmë janë diskutuar në pjesën që ka të bëjë me imunitetin e deputetëve dhe ato zbatohen njëjloj edhe për Presidentin e Republikës. Presidenti i Republikës është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës. Kreu i shtetit vepron brenda dhe jashtë si figurë e rëndësishme mbi të gjithë të tjerët në shtet dhe renditet njëjloj me të gjithë krerët e shteteve të tjera në botë për qëllime përfaqësimi. Imunitetet që i jepen Presidentit janë imunitete funksionale për të siguruar që Presidenti nuk do të pengohet në kryerjen e detyrave shtetërore që i janë besuar atij institucioni me Kushtetutë.
119. Statusi i Presidentit të Republikës është i rregulluar edhe me Ligjin për Presidentin, Ligji Nr. 03/L-094. Privilegjet dhe imuniteti që i jepen Presidentit me Kushtetutë dhe Ligj shkojnë me rolin e kreut të shtetit. Prandaj imuniteti funksional që i jepet Presidentit e bën atë imun për veprimet dhe vendimet e tij/saj brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tij/saj dhe ai imunitet mbulon lirimin nga përgjegjësia për veprimet dhe vendimet e tij/saj brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tij/saj, dhe veçanërisht nuk mund të ketë ndjekje penale, padi civile dhe shkarkim.
120. Neni 8 i Ligjit për Presidentin gjithashtu përcakton që imuniteti funksional vazhdon edhe pasi Presidenti të ketë përfunduar mandatin e tij/saj.
121. Sa i përket pyetjes së dytë, secila pjesë meriton përgjigje të veçantë.
- a) **Imuniteti nga ndjekja penale për veprimet dhe vendimet jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të Presidentit.**
122. Kushtetuta, në nenin 91 (1), i referohet shkarkimit të Presidentit nëse ai/ajo është dënuar për kryerjen e krimit të rëndë. Nëse dënimi për krim të rëndë është arsye për shkarkimin e tij/saj, është e qartë se Presidenti duhet të dënohet, dhe hetimi penal dhe gjykimi medoemos duhet t'i paraprijnë këtij dënimi. Prandaj, Presidenti nuk gëzon imunitet nga ndjekja penale për veprimet dhe vendimet jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tij/saj.
- b) **Imuniteti nga paditë civile për veprimet dhe vendimet jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tij/saj.**
123. Interpretimi i kësaj pjese të pyetjes është i njëjtë me atë për imunitetin e deputetëve. Nuk ka pengesë kushtetuese për ngritjen e padive civile për veprimet dhe vendimet jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tij/saj. Kjo buron nga gjuha e qartë që ka të bëjë me imunitetin funksional. Në një situatë të tillë, është e qartë se do të zbatohen dispozitat përkatëse të ligjeve në fuqi.
- c) **Imuniteti nga shkarkimi për veprimet dhe vendimet jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tij/saj.**
124. Kushtetuta ka një dispozitë të veçantë në nenin 91 e cila e trajton çështjen e shkarkimit të Presidentit. Kjo dispozitë nuk bën dallim të qartë për shkarkimin e Presidentit për veprimet apo vendimet brenda apo jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tij/saj. Presidenti mund të shkarkohet pas dënimit për krim të rëndë, siç u cek më lart. Presidenti gjithashtu mund të shkarkohet nëse ai/ajo nuk është e/i aftë për të ushtruar përgjegjësitë e këtij posti për shkak të sëmundjes së rëndë ose nëse Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar se ai/ajo ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës. Vendimin për shkarkim e merr Kuvendi pas procedurave të përcaktuara në nenin 91 (2) dhe (3) të Kushtetutës.

d) Imuniteti nga arrestimi dhe ndalimi për veprimet dhe vendimet jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tij/saj.

125. Presidenti ushtron funksione unike që i janë dhënë vetëm atij/asaj. Sipas Kushtetutës, Presidenti duhet të jetë në dispozicion gjatë gjithë kohës për t'i kryer këto funksione. Ato janë të pandashme nga Presidenca dhe prandaj, Presidenti nuk guxon të pengohet me arrestim dhe ndalim në ushtrimin e këtyre funksioneve. Presidenti duhet përherë të jetë në dispozicion për t'i kryer funksionet e institucioneve dhe çështjet e shtetit.
126. Kur neni 90 i referohet mungesës së përkohshme të Presidentit, nuk ka asnjë indikacion se arrestimi apo ndalimi parashikohet. Është e pakuptimtë të sugjerohet që mungesa e përkohshme e Presidentit do të mund të lidhej me kalimin vullnetar të detyrave të tij/saj për një periudhë të caktuar kohore në lidhje me arrestimin apo ndalimin.
127. Arrestimi dhe ndalimi i një personi të tillë është në kundërshtim me ato ideale të Presidentit që përfaqëson unitetin e popullit dhe mishëron shtetësinë si kreu i shtetit. Mjeti përkatës është procedimi kundër Presidentit në përputhje me Kushtetutën.
128. Presidenti mund të arrestohet apo ndalohet vetëm pasi të shkarkohet, sepse ai/ajo më nuk është President, por qytetar i rëndomtë për të cilin vlejné ligjet e zakonshme.

C Lidhur me imunitetin e anëtarëve të Qeverisë të Kosovës

129. Në pjesën e kërkesës së Qeverisë lidhur me imunitetin e anëtarëve të Qeverisë parashtrihen dy pyetje.

- i) Interpretimi i zbatueshmërisë dhe i efektit të nenit 98 të Kushtetutës.
- ii) Sqarimi i imunitetit të anëtarëve të Qeverisë nga ndjekja penale, paditë civile, shkarkimi dhe arrestimi apo ndalimi për veprimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre.

130. Gjykata vë në pah që Qeveria kërkon sqarim lidhur me:

- a) nëse anëtarët e Qeverisë gëzojnë imunitet nga ndjekja penale për veprimet dhe vendimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre;
- b) nëse anëtarët e Qeverisë gëzojnë imunitet nga paditë civile për veprimet dhe vendimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre;
- c) nëse anëtarët e Qeverisë gëzojnë imunitet nga shkarkimi për veprimet dhe vendimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre; dhe
- d) nëse anëtarët e Qeverisë gëzojnë imunitet nga arrestimi dhe ndalimi për veprimet dhe vendimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre.

131. Neni 98 i Kushtetutës trajton çështjen e imunitetit të anëtarëve të Qeverisë, dhe përcakton:

Neni 98 [Imuniteti]

Anëtarët e Qeverisë së Kosovës gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi për veprimet dhe vendimet brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si anëtarë të Qeverisë.

132. Edhe anëtarët e Qeverisë gëzojnë imunitet funksional si deputetët e Kuvendit dhe Presidenti. Përsëri, ky imunitet është për veprimet dhe vendimet e ndërmarra brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre, të përcaktuara në nenin 97 të Kushtetutës. Ata gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi brenda fushëveprimit të këtij imuniteti funksional.
133. Për dallim nga qëndrimi lidhur me deputetët e Kuvendit dhe Presidentin, anëtarët e Qeverisë i japin llogari Kuvendit. Ata, me Kryeministrin dhe zëvendëskryeministrin (zëvendëskryeministrat) kanë përgjegjësi të përbashkët për veprimet e Qeverisë dhe përgjegjësi individuale për veprimet e ndërmarra brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre. Kjo është përgjegjësi politike dhe tërësisht dallon nga imuniteti i tyre funksional. Ata janë të zgjedhur nga Kuvendi, dhe prandaj i japin llogari Kuvendit.
134. Për anëtarë të Qeverisë nuk ka mbrojtje të posaçme për veprimet jashtë atij fushëveprimit. Sa u përket anëtarëve të Qeverisë, nëse akuzohen për vepra penale, ata nuk dallojnë nga qytetarët e tjerë të Republikës së Kosovës.
135. Sa u përket të katër pjesëve të pyetjes së dytë të Qeverisë, anëtarët e Qeverisë nuk gëzojnë mbrojtje të posaçme për veprimet dhe vendimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre. Në rrethana të tilla, ata nuk gëzojnë imunitet dhe mund të ndiqen penalisht, ndaj tyre mund të ngrihen padi civile dhe mund të arrestohen apo ndalohen si çdo qytetar tjetër i rëndomtë. Shkarkimi dhe emërimi i anëtarëve të Qeverisë bëhet në përputhje me procedurat specifike të përcaktuara në nenet 95 dhe 96 të Kushtetutës.

**PËR KËTO ARSYE,
GJYKATA NJËZËRI VENDOS ME SA VIJON:**

- I. Kërkesa është e pranueshme;
- II. Në përputhje me nenin 75 (1), nenin 89 dhe nenin 98 të Kushtetutës, deputetët e Kuvendit të Kosovës, Presidenti i Republikës dhe anëtarët e Qeverisë gëzojnë imunitet funksional për veprimet dhe vendimet e ndërmarra brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre përkatëse. Prandaj, deputetët e Kuvendit, Presidenti i Republikës dhe anëtarët e Qeverisë lirohen nga përgjegjësia në procedura gjyqësore të çfarëdo natyre mbi pikëpamjet e shprehura, mënyrën e votimit apo vendimet e ndërmarra brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre. Ky lloj i imunitetit ka kohëzgjatje të pakufizuar.

A. Lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit

III. Veprimi jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre:

1. Deputetët nuk gëzojnë imunitet nga ndjekja penale për veprimet dhe vendimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre. Kjo ka të bëjë me ndjekjen penale për veprat penale të cilat pretendohen të jenë kryer para fillimit të mandatit të tyre dhe gjatë rrjedhës së mandatit të tyre si deputetë;

2. Deputetët nuk gëzojnë imunitet nga paditë civile për veprimet dhe vendimet jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre;
3. Deputetët e Kuvendit nuk mund të shkarkohen përveç arsyeve të përcaktuara në nenin 70 të Kushtetutës.

IV. Arrestimi apo ndalimi tjetër i deputetit:

1. Deputeti mund të arrestohet apo ndalohet gjatë kohës që është duke kryer detyrat e tij/saj, pra në mbledhjet e Kuvendit dhe/ose në mbledhje të komisioneve të tij, pas vendimit të Kuvendit.
2. Deputeti mund të arrestohet apo ndalohet gjatë kohës që nuk është duke kryer detyrat e tij/saj, pra kur nuk ka mbledhje të Kuvendit ose mbledhje të komisioneve të tij, edhe pa vendim të Kuvendit.
3. Deputeti mund të arrestohet apo ndalohet nëse kapet në kryerje e sipër (*in flagrante*) të një vepre të rëndë penale, që është e dënueshme me pesë (5) ose më shumë vjet burgim, edhe pa vendim të Kuvendit.
4. Deputeti mund të arrestohet apo ndalohet kur mandati i tij/saj mbaron për shkak të dënimit me një ose më shumë vjet burgim me një vendim gjyqësor të formës së prerë për shkak të kryerjes së veprës penale.

V. "Përderisa është duke kryer detyrat e tij/saj" nënkupton punën gjatë mbledhjeve të Kuvendit dhe mbledhjeve të komisioneve të tij.

VI. Çdo organ/institucion i ndjekjes penale që është duke kryer ndjekjen penale të personave të akuzuar për kryerje të veprave penale, siç përcaktohet në nenin 109 të Kushtetutës, dhe që vepron brenda juridiksionit të përcaktuar sipas ligjit në fuqi për Republikën e Kosovës ka të drejtë të kërkojë nga Kuvendi që t'ia heqë imunitetin një deputeti.

Ky organ/institucion është i autorizuar ta arrestojë apo ndalojë deputetin edhe pa vendim të Kuvendit gjatë kohës që deputeti nuk është duke kryer detyrat e tij/saj, pra kur nuk ka mbledhje të Kuvendit ose mbledhje të komisioneve të tij.

B. Lidhur me imunitetin e Presidentit të Republikës

VII. Kur vepron jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tij/saj përkatëse:

1. Presidenti nuk gëzon imunitet nga ndjekja penale për veprimet dhe vendimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tij/saj. Ndjekja penale mund të iniciohet dhe zhvillohet kundër Presidentit për një krim të rëndë.
2. Presidenti nuk gëzon imunitet nga paditë civile për veprimet dhe vendimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tij/saj.
3. Presidenti mund të shkarkohet nga Kuvendi vetëm në përputhje me nenin 91 të Kushtetutës.
4. Presidenti nuk mund të arrestohet apo ndalohet gjatë mandatit të tij/saj për shkak të natyrës së funksionit të Presidentit, pasi ai/ajo kërkohet të jetë përherë në dispozicion për t'i kryer ato.

C. Lidhur me imunitetin e anëtarëve të Qeverisë

VIII. Anëtarët e Qeverisë nuk gëzojnë mbrojtje të posaçme për veprimet dhe vendimet e tyre të ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre.

D. Lidhur me efektet juridike të këtij Aktgjykimi

IX. Ky Aktgjykim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare në përputhje me nenin 20.4 të Ligjit.

X. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Snezhana Botusharova



Gjyqtare raportuese



Prof. dr. Enver Hasani



Kryetar i Gjykatës Kushtetuese